

# Hollësi te Lluca 17 dhe Veprimtaria e Përfytyrimit

MANUALI I SEMINARIT PËR DHIATËN E RE

**Lexo me kujdes te Lluca 17:11–14, duke iu kushtuar vëmendje hollësive.**

Pasi të lexosh, përpiku t'u përgjigjesh sa më shumë prej pesë pyetjeve vijuese që mundesh pa iu referuar shkrimeve të shenjta.

1. Sa afër Shpëtimtarit ishin lebrosët?
2. Çfarë i kërkuan lebrosët Shpëtimtarit?
3. Çfarë u tha Shpëtimtari atyre?
4. Sa prej lebrosëve patën besimin për të bërë atë që u kërkoi Shpëtimtari?
5. Çfarë bënë lebrosët pasi u shëruan?

**Përfytyro atë që lexon.**

Përfytyro sikur je një prej lebrosëve që u pastruan.

- Si mund të ketë qenë të shëroheshe nga lebra? Si do të ishte ndier?
- Si mendon, pse shërimi në këtë rrëfim ndodhi “ndërsa ata po shkonin”? (Vargu 14.)
- Si mendon, çfarë do të kishe bërë sapo të kuptoje se Shpëtimtari të kishte shëruar?